

---

## AKT THEMELIMI “LUMESHI HOLDING” SHPK

### **1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë “**Lumeshi Holding**” **SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “**SHPK**”.

### **2. Ortaku i vetëm i shoqërisë**

Ortak i Vetëm i shoqërisë është: **Z. Myftar Lumeshi**, i biri i Musait, i datëlindjes 06.07.1964, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. 037168858 dhe Nr. Personal G40706049A, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

**Shoqëria do të organizohet dhe funksionojë si një shoqëri HOLDING, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin tregtar të shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja.**

**Në funksion dhe përbushje të objektit të sipërcituar të aktivitetit, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion të ligjshëm tregtar e financiar, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e saj për të investuar në instrumente financiarë, tituj pjesëmarrje në kapitale, tituj borxhi, aksione e kuota dhe/ose fonde investimesh.**

**Ofrimi i asistencës dhe konsulencës teknike, ligjore, financiare, administrative dhe shërbime të tjera të ligjshme të çdo lloji (pa kufizim) kundrejt shoqërive të tjera të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ajo vetë apo ortakët e saj (shoqëritë e grupit). Shoqëria mundet sipas rastit:**

- a) Të koordinojë në aspektin ligjor, teknik, administrativ, financiar dhe organizativ të gjitha shoqëritë e grupit, duke krijuar për këtë qëllim borde të centralizuara menaxhimi dhe administrimi;
- b) Të ofrojë këshillim financiar duke përfshirë por pa u kufizuar në analizën financiare për strategjitet e zhvillimit, përgatitjen e planeve të biznesit / financimit, këshillim dhe asistencë në operacionet e investimeve, studim dhe kërkim burimesh financiare



---

me kushte lehtësuese si dhe asistencë në operacionet e investimeve të paluajtshme;

- c) Të japë garanci të të gjitha llojeve në favor të shoqërive të grupit dhe të ofrojë shërbime të analizës, koordinimit, studimeve të tregut, marketingut, etj.
- d) Të orientojë dhe miratojë vendosjen e objektivave dhe strategjive, koordinimin e aktiviteteve të shoqërive të grupit, të vendosë objektivat financiare, të kontrollojë sjelljen dhe efektivitetin finanziar, dhe në përgjithësi, menaxhimin dhe kontrollin finanziar si dhe mbështetjen në këtë drejtim të shoqërive të grupit.

Shoqëria do të ketë si objekt të aktivitetit të saj gjithashtu, shitblerje, shkëmbim të pasurive të paluajtshme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Aktivitet në fushën e hoteleri turizëm, bar-restorant. Administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimitarës së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### 4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Shqipëri, Tiranë, Bulevardi "Bajram Curri", Nd. "ETC", Sh.B, Ap.8/6.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të Asamblesë së ortakëve.

#### 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimitarës së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### 6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 10.000 (dhjetë mijë lekë)**.

- 
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **ALL 10.000 (dhjetë mijë lekë)** dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

## 7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

## 8. Administratori


- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Myftar Lumeshi**, i biri i Musait, i datëlindjes 06.07.1964, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. 037168858 dhe Nr. Personal G40706049A.

## 9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**ORTAKU I VETËM**

**Myftar Lumeshi**



[emër, mbiemër, firmë]

Datë 26/01/2023